



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.8/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi, YTHP, me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi, KDTP, me seli në Prizren, për shkeljes se dispozitave të Kodit të Miresjelljes per periudhën e fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 29.08.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e palejuar, ankesa e subjektit politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi, YTHP, me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi, KDTP, me seli në Prizren, për shkeljen e dispozitave të Kodit të Miresjelljes per periudhën e fushatës zgjedhore, në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025,

A r s y e t i m

Me datë 28.08.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi, YTHP, me seli në Prizren, në të cilën thekson se me datën 26 gusht 2025 në rrjetin social facebook Kryetari i Komunes së Mamushes dhe njekosisht kandidat per kryetar te komunës nga rradhet e KDTP-se Abdulhadi Krasniq ka bërë një postim publik ku ai ka njoftuar për organizimin e një udhëtimi për votuesit që jetojnë jashtë vendit, veçanërisht në Turqi, megjithatë është theksuar se ky udhëtim do të jetë i dedikuar vetëm për ata qytetarë që dëshirojnë të votojnë subjektin politik KDTP, të cilin e përfaqëson vetë Krasniq aktualisht nën kryetar i subjektit politik. Partashtruesi i ankesës thekson se me këtë postim janë shkelur dispozita ligjore te nenit 3 paragrafi 3.1 fjalia 5 dhe paragrafi 3.4 i Ligjit Nr 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale dhe nenit 34 paragrafi 1.6 i Ligjit Nr. 08/L-228 per Zgjedhjet e Pergjithshme, nenit 33 paragrafi f i Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike , mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Si dëshmi ka bashkangjitur postimin dhe përkthimin e tij. Parashtruesi i ankesës kërkon që PZAP të ndërmerr masat ndëshkuese në përputhje me dispozitat ligjore.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik KDTP, theksohet se ankesa mbështetet mbi një keqinterpretim të përmbajtjes së postimit në fjalë. Në tekstin e postuar është përmendur një organizim për transportin e qytetarëve që jetojnë në Bursa dhe që dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre kushtetuese të votës në Komunën e Mamushës. Në asnjë rast nuk është thënë apo nënkuptuar se ky transport është financuar nga buxheti i Komunës së Mamushës apo nga ndonjë fond publik. Përkundrazi, është fjala për një iniciativë qytetare të ndërmarrë nga simpatizantët e partisë, e realizuar me mjetet e tyre personale. E drejta e votës është e drejtë individuale dhe e fshehtë. Për rrjedhojë, nuk ka asnjë garanci apo siguri se kush do të votojë për kë, dhe për këtë arsye ëdo pretendim se kjo iniciativë është përdorur për përfitim elektoral është

i pabazuar. Duke u nisur nga parimi i mirëbesimit, ky veprim duhet të konsiderohet thjesht si një keqkuptim dhe jo si shkelje e ligjeve zgjedhore. Ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete që do të vërtetonte pretendimin e tij për përdorim të pasurisë publike apo të buxhetit komunal në një fushatë zgjedhore. Për të gjitha arsyet e sipërpërmendura, kërkojmë nga Paneli që ankesa e paraqitur të refuzohet si në aspektin procedural ashtu edhe në atë material.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr. 07/2024 Fushata e zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar nën 2 përcakton se fushata e zgjedhjeve fillon tridhjet (30) ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përfundon me hapjen e qendrave të votimit në ditën e zgjedhjeve siç përcaktohet në nënparagrafin 29, të paragrafit 1 të nenit 3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Sipas Nenit 34 dhe 44 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ku ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Periudha për fillimin e fushatës zgjedhore e përcaktuar nga KQZ-ja, për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, fillon nga data 13.09.2025 dhe zgjat deri më datën 12.10.2025 në ora 06:59, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë zgjedhore, Paneli konstaton se ankesa në fjalë është e palejuar ngase as me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme e as me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për këtë periudhë të para fushatës zgjedhore.

Bazuar në arsyet e sipërshtënuara dhe në kuptim të 115 par.1 dhe nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Nenit 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim.”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.8/2025, datë: 29.08.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.